

“INSIFA 6 VELLEZERIT” sh.p.k.

Pasqyra Financiare individuale

(Per periudhen 01.01.2016 deri 31.12.2016)

PERMBAJTJA

Nr.	Emertimi	Faqe
1	Raporti i audituesit te pavarur	3-4
2	Pasqyra e pozicionit financiar	4-6
3	Pasqyra e performances dhe e te ardhurave gjithëpërfshirëse	7
4	Pasqyra e ndryshimeve ne kapitalin neto	8
5	Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare	9
6	Shenime per pasqyrat financiare	10-18

Pasqyra e Pozicionit Financiar

Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2016

Nr	A K T I V E T	Shenime	31.12.2016	31.12.2015
	Aktivët Afatshkurtra			
	► Aktivët monetare	1	5,351,132	13,089,192
	1 Banka		5,320,531	12,501,407
	2 Arka		30,601	587,785
	► Investime			
	► Të drejta të arkëtueshme		94,974,791	37,095,933
	1 Nga aktiviteti i shfrytëzimit	2	34,976,583	32,429,711
	2 Nga njësitë ekonomike brenda grupit		0	0
	3 Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse			
	4 Të tjera	3	59,998,208	4,666,222
	5 Kapital i nënshkruar i papaguar			
	► Inventarët	4	113,191,910	84,935,802
	1 Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme		77,542,500	51,985,956
	2 Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte			
	3 Produkte të gatshme		33,484,311	30,350,689
	4 Mallra		2,165,099	2,599,157
	5 Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)			
	6 AAGJM të mbajtura për shitje			
	7 Parapagime për inventar			
	► Shpenzime të shtyra		0	0
	► Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara			
I	TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA		213,517,833	135,120,926
	Aktivët Afatgjata			
	► Aktive financiare			
	1 Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit			
	2 Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit			
	► Aktivët materiale	5	237,166,761	83,889,914
	1 Toka dhe ndërtesa		186,864,185	32,236,450
	2 Impiante dhe makineri		48,958,129	50,695,446
	3 Të tjera Instalime dhe pajisje		1,344,447	958,018
	4 Parapagime për aktive materiale dhe në proces			
	► Aktivët biologjike		0	634,865
	► Aktive jo materiale:			
	1 Koncesione, patenta, licenca, marka tregtare, të drejta dhe aktive të ngjashme			
	2 Emri i Mirë			
	3 Parapagime për AAJM			
	► Aktive tatimore të shtyra		0	0
	► Kapitali i nënshkruar i papaguar			
II	TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA		237,166,761	84,524,779
	AKTIVE TOTALE		450,684,594	219,645,705

Keto pasqyra financiare te lexohen se bashku me shenimet nr.1-24 bashkelidhur.

Pergatiti

Ermal Osmani

Administrator

Ndricini Osmani

Pasqyra e Pozicionit Financiar

Per vitin ushtrimor të mbyllur me 31 Dhjetor 2016

Nr	DETYRIMET DHE KAPITALI	Shenime	31.12.2016	31.12.2015
►	Detyrime afatshkurtra:		136,352,388	46,771,619
1	Titujt e huamarrjes			
2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	6	11,387,874	1,875,078
3	Arkëtime në avancë për porosi		0	0
4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	7	117,754,946	33,680,301
5	Dëftesa të pagueshme			
6	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike brenda grupit			0
7	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse			
8	Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore	8	7,160,726	6,967,110
9	Të pagueshme për detyrimet tatimore	9	48,842	4,249,130
10	Të pagueshme për detyrimet ndaj ortakut		0	0
►	Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		0	0
►	Të ardhura të shtyra		0	0
►	Provizione		421,337	0
	Totali i Detyrimeve afatshkurtera		136,773,725	46,771,619
►	Detyrime afatgjata:		180,068,477	43,500,000
1	Titujt e huamarrjes			
2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	10	119,245,477	0
3	Arkëtimet në avancë për porosi			
4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	11	60,823,000	43,500,000
5	Dëftesa të pagueshme			
6	Të pagueshme për detyrimet ndaj ortakut		0	0
►	Të pagueshme për shpenzime të konstatuara			
►	Të ardhura të shtyra			
►	Provizione:		0	421,337
1	Provizione për pensionet			
2	Provizione të tjera		0	421,337
►	Detyrime tatimore të shtyra			
	Totali i Detyrimeve afatgjata		180,068,477	43,921,337
	DETYRIMET TOTALE		316,842,202	90,692,956
►	Kapitali dhe Rezervat			
►	Kapitali i Nënshkruar	12	86,010,371	86,010,371
►	Primi i lidhur me kapitalin			
►	Rezerva rivlerësimi			
►	Rezerva të tjera		36,942,379	29,158
1	Rezerva ligjore		29,158	29,158
2	Rezerva statutore			
3	Rezerva të tjera	13	36,913,221	0
►	Fitimi i pashpërndarë			
►	Fitim / Humbja e Vitit	14	10,889,642	42,913,221
	Totali i Kapitalit		133,842,392	128,952,750
	TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		450,684,594	219,645,706

Keto pasqyra financiare të lexohen së bashku me shenimet nr.1-24 bashkelidhur.

Pergatiti

Ermal Osmani

Administrator

Ndriçim Osmani



Pasqyra e Performancës

Per vitin ushtrimor 1 Janar - 31 Dhjetor 2016

Formati 1 – Shpenzimet e shfrytëzimit të klasifikuara sipas natyrës

Nr	Pershkrimi i Elementeve	Shenime	Viti 2016	Viti 2015
▶	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	15	368,114,624	381,742,027
▶	Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces	16	3,133,622	13,728,983
▶	Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar			
▶	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit		0	0
▶	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	17	-299,581,090	-290,880,251
	1 Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		-299,581,090	-290,880,251
	2 Të tjera shpenzime			
▶	Shpenzime të personelit	18	-37,250,216	-29,226,674
	1 Paga dhe shpërblime		-31,911,383	-25,035,414
	2 Shpenzime të sigurimeve shoq/shënd (paraqitur veçmas nga shp për pensionet)		-5,338,833	-4,191,260
	3 Të tjera personeli			
▶	Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		0	0
▶	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	5	-5,397,702	-11,449,078
▶	Shpenzime të tjera shfrytëzimi	19	-14,773,029	-12,257,103
▶	Të ardhura të tjera		2,097,057	612,014
	1 Të ardhura nga njësitet ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitet ekonomike brenda grupit)			
	2 Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitet ekonomike brenda grupit)			
	3 Interesa të ortakëve dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitet ekonomike brenda grupit)	20	2,097,057	612,014
▶	Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra		0	0
▶	Shpenzime financiare		-3,057,129	-1,462,435
	1 Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitet ekonomike brenda grupit)	21	-3,057,129	-1,462,435
	2 Shpenzime të tjera financiare			
▶	Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet		0	0
▶	Fitimi/Humbja para tatimit		13,286,136	50,807,483
▶	Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		-2,396,494	-7,894,262
	1 Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	22	-2,396,494	-7,894,262
	2 Shpenzimi i tatimit fitimit të shtyrë			0
	3 Pjesa e tatimit fitimit të pjesëmarrjeve			
▶	Fitimi/Humbja e vitit	14	10,889,642	42,913,221
▶	Fitimi/Humbja për:		0	0
	Pronarët e njësive ekonomike mëmë			
	Interesat jo-kontrolluese			

Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse

Nr	Pershkrimi i Elementeve	2016	2015
▶	Fitimi/Humbja e vitit	10,889,642	42,913,221
	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:		
	Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja		
	Diferencat (+/-) nga rrvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		
	Diferencat (+/-) nga rrvlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura për shitje		
	Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet		
▶	Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	0	0
▶	Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	10,889,642	42,913,221
▶	Totali i të ardhurave/humbjeve gjithëpërfshirëse për:		
	Pronarët e njësive ekonomike mëmë		
	Interesat jo-kontrolluese		

Keto pasqyra financiare të lexohen së bashku me shenimet nr.1-24 bashkëlidhur.

Pergatiti

Ermal Osmani

Administrator

Ndricim Osmani



Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2016

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërdara	Fitim / Humbja e vitit	Totali	Interesa Jo-Kontrollues	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2014	67,975,263	29,158			18,035,108	86,039,529		86,039,529
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël						-		
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2015	67,975,263	29,158	-	18,035,108	-	86,039,529		86,039,529
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:						-		-
Fitim / Humbja e vitit					42,913,221	42,913,221		42,913,221
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:						-		-
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:						-		-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:						-		-
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	18,035,108			-18,035,108		-		-
Zvogëlimi i kapitalit të aksionar						-		-
Dividendë të paguar						-		-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike						-		-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	86,010,371	29,158	-	-	42,913,221	128,952,750		128,952,750
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël						-		-
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2016	86,010,371	29,158	-	42,913,221	-	128,952,750		128,952,750
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:						-		-
Fitim / Humbja e vitit					10,889,642	10,889,642		10,889,642
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:						-		-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:						-		-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:						-		-
Emetimi i kapitalit të nënshkruar						-		-
Dividendë të paguar				- 6,000,000		- 6,000,000		- 6,000,000
Caktimi i fitimit të pashpërdarë			36,913,221	-36,913,221		-		-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike						-		-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	86,010,371	29,158	36,913,221		10,889,642	133,842,392	-	133,842,392

Keto pasqyra financiare është e vërtetë së bashku me shënime nr.1-24 bashkëlidhur.

Pergatiti

Ermed Osman

Administratori

Ndrim Osman



Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
(metoda indirekte)

	Viti 2016	Viti 2015
► Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		
Fitim / Humbja e vitit	13,286,136	50,807,483
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	1,854,293	-460,095
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	-2,396,494	-7,894,262
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	5,397,702	11,449,078
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		
Zhvlerësimi i kerkesave për tu arkëtuar		
Grante etj jomonetare		
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(ritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	-57,878,858	22,075,590
Rënie/(ritje) në inventarë	-28,256,108	8,075,908
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	95,322,279	-892,392,08
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	193,616	455,833
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	27,522,565	-4,729,673
► Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Para neto të përdorura për blerjen e fillaleve		
Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	-158,039,686	-21,483,070
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
Pagesa për blerjen e investimeve të tjera		
Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera		
Dividentë të arkëtuar		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	-158,039,686	-21,483,070
► Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar		
Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral		
Hua të arkëtuara	137,330,000	
Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë		
Riblerje e aksioneve të veta		
Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral		
Pagesa e huave	-6,696,648	-1,875,078
Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare		
Interes i paguar	-2,814,365	-390,326
Dividendë të paguar	-6,000,000	
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	121,818,987	-2,265,404
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	-8,698,134	-28,478,147
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar 2016	13,089,192	40,716,918
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	960,074	850,421
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor 2016	5,351,131	13,089,192

Keto pasqyra financiare të lexohen së bashku me shenimet nr.1-24 bashkëlidhur.

Pergatiti
Ernal Osmani

Administrator
Ndrim Osmani

SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE

(të Ushtrimit të mbyllur më dt. 31.12.2016)

LIFORMACIONE TE PERGJITHESHME

Shoqeria "Insifa 6 Vellezerit" sh.p.k. është themeluar me date 08.01.1998 dhe është regjistruar ne Gjykate me vendimin nr. 18922, date 15.03.1999.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", nga statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi per tatimet dhe taksat.

Objekti: Prodhim, Import-Eksport, shit-blerje me shumice e pakice e mallrave ushqimore, industriale etj.

Certifikimi tatimor: NIPT J91515501K

Kapitali i regjistruar është 86,010,371 leke, i ndare ne 8 kuota (ne vitin 2015 ka patur 6 kuota) si vijon:

Kuotat e pronesisë:

- Z.Ndricim Osmani, zoterues i 1 kuote, qe perben 16% te kapitalit te regjistruar;
- Z.Sulejman Osmani, zoterues i 1 kuote, qe perben 17% te kapitalit te regjistruar;
- Z. Fatbardh Osmani, zoterues i 1 kuote qe perben 17% te kapitalit te regjistruar;
- Z. Ilmi Osmani, zoterues i 1 kuote, qe perben 16% te kapitalit te regjistruar;
- Z. Altin Osmani, zoterues i 1 kuote qe perben 17% te kapitalit te regjistruar;
- Zj. Zoje Osmani, zoterues i 1 kuote qe perben 5.67% te kapitalit te regjistruar;
- Z. Edvin Osmani, zoterues i 1 kuote qe perben 5.67% te kapitalit te regjistruar;
- Z. Ermal Osmani, zoterues i 1 kuote qe perben 5.67% te kapitalit te regjistruar.

Perfaqesues ligjor: z.Ndricim Osmani, me te drejta dhe detyra te percaktuara ne statutin e shoqerise, me afat emerimi 05.9.2011-05.09.2021

Forma juridike e shoqerise: Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar

Adresa e selise : Maminas Durres.

Shoqeria kryen aktivitetin e saj ne ambjente qe jane ne pronesi dhe te marra me qira, per zyra dhe magazina, si dhe me mjetet e transportit, te cilat jane te pajisura me NIPT-e sekondare per te realizuar shitjet . Mjetet e transportit jane ne pronesi te shoqerise.

Numri i punonjese me date 31 Dhjetor 2016 është 95 punonjes, nga 86 punonjes qe ishte me date 31 Dhjetor 2015.

2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL

Bazat per pergatitjen e pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne te gjitha aspektet materiale, duke respektuar kerkesat e parashikuara ne Ligjin nr. 9228 date 29.04.2004 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" te ndryshuar si dhe parimet baze e rregullat e parashikuara ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK).

Per zbatimin e politikave kontabel per vleresimet si dhe per te tjera elemente te nevojshem per pergatitjen e pasqyrave financiare (PF) te vitit 2016, jemi referuar tek SKK nr.1- "Kudri i pergjithshem per pergatitjen e pasqyrave financiare". Politikat kontabel janë parimet specifike, bazat, konvencionet, rregullat dhe praktikat e zbatuara nga një njësi ekonomike në përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare. Pasi përzgjidhet një politikë kontabel, ajo zbatohet në mënyrë të qëndrueshme vit pas viti. Politika kontabel mund të ndryshojë ne raste specifike, te parashikuara ne SKK.

Lista e llogarive e perdorur per mbajtjen e regjistrimeve kontabel, është ajo e shpallur nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit. Pasqyra e Pozicionit Financiar, Pasqyra e Performancës, Pasqyra e Fluksit te Mjeteve Monetare dhe Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapitalin Neto, jane paraqitur sipas formatit te parashikuar ne SKK-2 të përmirësuar. Informacioni per gjendjen me date 31.12.2016 është plotesisht i krahasueshem per cdo element te PF. Ne shenimet shpjeguese jane paraqitur vlerat analitike per cdonjerin prej tyre.

Sipas parimeve te kontabilitetit te pranuar gjeresisht ne Shqiperi, deklarimet financiare jane pergatitur mbi bazen e konceptit materialitetit, te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara, te parimit te vijimesise etj, sipas SKK 1.

Bazat e përgatitjes

Disa të dhëna financiare, të paraqitura në pasqyrat financiare, bazohen në vlerësime të bëra nga drejtuesit e njësisë ekonomike, dhe jo në fakte të vëzhguara në mënyrë objektive. Shembuj të zbatimit të vlerësimeve kontabël janë:

(a) vlerësimi i zhvlerësimeve për kërkesat e arkëtueshme dhe inventarëve;

(b) vlerësimi i jetës së dobishme të aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale, si dhe përcaktimi i normave përkatëse të amortizimit;

(c) krijimi i provizioneve për shitjet me garanci ose për mbulimin e kostove që lidhen me procedurat gjyqësore në proces.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Vlerat në pasqyrat financiare janë shprehur në monedhën kombëtare LEKE.

Bazat e matjeve

Në përgatitjen e pasqyrave financiare janë zbatuar parimet kontabël që njihen si më të përshtatshme për të matur dhe paraqitur gjendjen financiare, rezultatit financiar dhe fluksin e parasë mbi gjendjen e kontabilitetit rrjedhës

(të drejtat dhe detyrimet e konstatuara). Matja fillestare e aktiveve dhe detyrimeve që plotësojnë kriterin e njohjes, bëhet me koston historike, përveç rasteve kur SKK 1, kërkon matje fillestare mbi një bazë tjetër të tillë si vlera e drejtë. Vlerësimi i mëposhtëm i aktiveve dhe detyrimeve financiare bëhet me kosto të amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm, sikurse përcaktohet në SKK 3, ndërsa të aktivet dhe pasivet e tjera duhet ti referohemi rast pas rasti SKK-ve përkatëse.

Njohja e të ardhurave

Të ardhurat përfaqësojnë fluksin hyrës (rritjen e përfitimeve ekonomike) gjatë periudhës raportuese, që çojnë në rritjen e aktiveve ose pakësimin e pasiveve, si dhe që rrisin kapitalin e njësisë ekonomike raportuese, duke përjashtuar këtu ato që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital. Të ardhurat përfshijnë vetëm hyrjet bruto të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga njësia ekonomike për llogari të vet. Shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, si dhe tatimi i vlerës së shtuar nuk janë përfitime ekonomike që hyjnë në njësinë ekonomike dhe nuk sjellin rritje të kapitalit neto. Për këtë arsye ato nuk përfshihen në të ardhura.

Të ardhurat përfshijnë vetëm vlerën e drejtë të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga shitja e mallrave dhe shërbimeve gjatë aktivitetit të zakonshëm të kompanisë.

Në lidhje me shitjen e mallrave, të ardhurat janë njohur kur ndryshimi i pronësive së bashku me riskun që vjen nga ky ndryshim, janë transferuar tek blerësi.

Njohja e shpenzimeve

Shpenzimet që lidhen me të ardhurat e fituara gjatë periudhës raportuese njihen në të njëjtën periudhë kontabël si dhe të ardhurat përkatëse. Shpenzimet e kryera gjatë një periudhe raportuese, që ndryshon nga periudha kur ato i sjellin përfitime njësive ekonomike raportuese, regjistrohen si shpenzime pikerisht në periudhën kur merren përfitimet. Shpenzimet e ndodhura, për të cilat njësia ekonomike nuk prëft përfitime të ardhshme, njihen menjëherë në rezultatit financiar.

Aktivitet monetare

Në këtë ze përfshihen mjetet monetare gjendje në datë 31.12.2016 në llogaritë rrjedhëse pranë bankave të nivelit të dytë si dhe në arke. Për njohjen fillestare të ketyre elementeve si dhe për gjendjet, është përdorur politika kontabël e vlerës nominale.

Të drejta të arkëtueshme

Në këtë ze janë përfshirë kërkesat të arkëtueshme nga klientët nga aktiviteti i shfrytëzimit, si dhe kërkesat të tjera debitoare, të cilat janë vlerësuar me vlerë nominale minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm (nëse ka).

Detyrime të pagueshme

Në këtë grup janë përfshirë detyrimet e pagueshme ndaj institucioneve të kredise, furnitoreve, punonjësve, ortakëve për dividende dhe hua, kreditorëve të tjerë, etj. Në njohjen fillestare zerat e këtij grupi janë vlerësuar me kosto. Në fund të vitit detyrimet vlerësohen me kosto të amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm.

Parimisht, në vijim të njohjes fillestare, huatë dhe detyrimet e tjera paraqiten me kosto të amortizueshme duke njohur çdo diferencë midis koston dhe vlerës së rikuperueshme në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huamarrjes në bazë të një interesi efektiv.

Detyrime/ Të drejta tatimore

Ne këtë grup përfshihen të gjitha llojet e tatimeve e taksave, të llogaritura e të papaguara ndaj administratës tatimore, të cilat vlerësohen me vlerë nominale. Detyrimet tatimore afatshkurtra dhe afatgjata nuk skontojnë dhe nuk zhvlerësohen.

Inventaret

Inventaret maten fillimisht me kosto. Pas njohjes fillestare të tyre shoqëria vlerëson inventarin me vlerën me të ulët midis kostos dhe çmimit të mundshëm të shitjes minus koston e transaksionit të shitjes. Çmimi i mundshëm i shitjes i referohet vlerës neto që njësitë ekonomike raportuese pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrethën normale të biznesit.

Inventaret i nënshtrohen testit të zhvlerësimit në datën e mbylljes së bilancit. Shuma e Zhvlerësimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ka faktore të objektive që tregojnë që inventaret janë zhvlerësuar.

Metoda e përdorur nga shoqëria për llogaritjen e kostos së stokut është metoda e mesatares së ponderuar.

Aktive afatgjata materiale (AAM)

Në bilanc AAM paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi (nuk ka patur humbje nga zhvlerësimi në vitin 2016).

Në këtë grup janë paraqitur gjendjet e aktiveve afatgjata materiale që përbehen nga mjete transporti, makineri e vegla pune, pajisje informatike si dhe mobilje e pajisje zyre. Aktivët Afatgjata Materiale janë vlerësuar me koston e blerjes dhe koston e tjera të drejtperdrejta që lidhen me sjelljen e aktivitetit në kushtet e nevojshme për funksionimin e tij.

Metoda për llogaritjen e amortizimit për të gjitha AAM e shoqërisë, është metoda e vlerës së mbetur, e përcaktuar në Ligjin nr. 8438 datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat" të ndryshuar.

Normat vjetore të amortizimit të aplikuar janë si më poshtë vijon:

Përshkrimi	Norma vjetore	Metoda
Ndertese	5 %	Me vlerë të mbetur
Mjet transporti	20%	Me vlerë të mbetur
Makineri e vegla pune	20%	Me vlerë të mbetur
Pajisje informatike	25%	Me vlerë të mbetur
Mobilje e orëndi	20%	Me vlerë të mbetur

Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Aktivët e njohura si Parapagime dhe shpenzime të shtyra paraqiten në pasqyrat financiare me Vlerën nominale të shumës së parapaguar.

Shpenzime të konstatuara dhe të ardhura të shtyra

Detyrimet për shpenzime të konstatuara paraqiten me Vlerën nominale të shumës për të paguar, ndërsa detyrimet për të ardhurat e shtyra paraqiten në pasqyrat financiare me koston e amortizuar.

Kapitali

Kapitali i shoqërisë është përbehet nga kuotat e kapitalit, të cilat janë njohur me vlerën nominale, sikurse përcaktohet në statutin e shoqërisë.

Të ardhura të tjera dhe shpenzime financiare

Të ardhurat e tjera përbledhin të ardhurat nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse, të ardhurat nga interesi, fitimet nga shitja e aktiveve financiare të mbajtura për shitje dhe të aktiveve afatgjata materiale, si dhe fitimet nga kembimet valutore. Të ardhurat nga interesi njihen si detyrime atëherë kur përdoret metoda e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare paraqesin shpenzimet për interesat nga huatë, humbjet nga kembimet valutore, si dhe humbjet nga zhvlerësimet e aktiveve financiare. Gjithë koston e huamarrjeve njihen në humbje fitime mbi bazën e përdorimit të metodës së interesit efektiv.

Tatimi mbi të ardhurat

Shpenzimi (e ardhura) tatimor është shuma totale që i zbritet (shtohet) fitimit (humbjes) kontabël për përcaktimin e fitimit ose humbjes neto të periudhës kontabël, dhe përbëhet nga shpenzimi (e ardhura) tatimor aktual dhe shpenzimi (e ardhura) tatimor i shtyrë.

Tatimi aktual është shuma e tatimit mbi fitimin, e pagueshme (e zbritshme) mbi fitimin (humbjen) e tatueshëm të periudhës kontabël aktuale. Tatim fitimi është llogaritur në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi

të Ardhurat" te ndryshuar. Tatim fitimi është llogaritur ne masen 15% te te ardhurave te tatueshme.

Tatimi i shtyrë është tatimi i pagueshëm (i zbritshëm) në periudhat e ardhshme, zakonisht si rezultat i realizimit të aktiveve ose shlyerjes së detyrimeve nga njësi ekonomike me vlerën e tyre aktuale kontabël, dhe efekti tatimor i mbartjes së humbjeve tatimore dhe i tatimeve të zbritshme.

Transaksionet ne valute te huaj

Transaksionet ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen e perdorur duke perdorur kurset e kembimit ne daten e kryerjes se transaksionit.

Fitimet dhe humbjet qe rezultojne nga kryerja e transaksioneve ne monedhe te huaj dhe nga konvertimi i aktiveve monetare dhe detyrimeve ne monedhe te huaj me kursin e kembimit te fund-viit njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e kembimit te perdorura per vleresimin e gjendjeve ne valute me date 31.12.2016 dhe 31.12.2015 jane:

Monedha	31.12.2016	31.12.2015
EUR	135.23	137.28
USD	128.17	125.79

3. SHENIME SHPJEGUESE

1. Aktivët monetare

Likuiditete dhe vlera arke te tjera	31.12.2016	31.12.2015
Llogari ne banke	5,320,531	12,501,407
Llogari rrjedhese ne LEK	2,148,929	1,540,290
Llogari rrjedhese ne EUR	2,877,557	10,865,847
Llogari rrjedhese ne USD	294,045	95,270
Para ne dore	30,601	587,785
Ne monedhe vendase	30,601	587,785
Ne monedhe te huaj	0	0
Total mjete monetare	5,351,132	13,089,192

Vlera e mesiperme perfaqeson totalisht vleren e likuiditeteve me date 31.12.2016 gjendje ne llogarite qe shoqeria ka prane bankave te nivelit te dyte ne leke dhe valute si dhe gjendjen e arkës. Gjendja e likuiditeteve (ne banke) e paraqitur në bilanc rakordon me shumën e ekstrakteve të bankes.

2. Të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit

Emertimi	31.12.2016	31.12.2015
Kliente per shitje mallrash e sherbimesh	34,976,583	32,429,711
TOTAL	34,976,583	32,429,711

Ne kete rubrike jane paraqitur vlerat per tu arketuar nga te tretet, per shitje mallrash e produktesh, evidenca analitike e tecileve ndodhet bashkelidhur.

3. Të drejta të tjera

Emertimi	31.12.2016	31.12.2015
Parapagime te dhena (Furnitore te huaj)	39,077,891	952,766
TVSH kreditore	5,517,726	3,613,734
Dogana	45,828	99,722
Shteti Tvsh per rimbursim	11,166,973	0
Shteti -Tatim Fitimi	4,189,790	0
TOTAL	59,998,208	4,666,222

Ne kete rubrike jane paraqitur parapagimet e dhena furnitoreve jo rezidente, per furnizime te marra apo per tu marre ne vitin 2017, e drejta ndaj shtetit tvsh dhe per Tatim Fitimin e mbipaguar, si dhe te tjera te paguara me teper ne dogane.

4. Inventarët

Emertimi	31.12.2016	31.12.2015
Materiale te para	77,399,188	51,862,782
Objekte inventari	143,312	123,174
Produkte te gatshme	33,484,311	30,350,689
Mallra	2,165,099	2,599,157
TOTAL	113,191,910	84,935,802

Ne kete grup jane paraqitur gjendjet e inventarit te materialeve te para, te nevojshme per prodhimin e produkteve, produkte te gatshme te prodhuara dhe te tjera per shitje. Vleresimi i gjendjeve eshte bere me koston e blerjes apo te prodhimit.

5. Aktive afatgjata materiale

Aktive Afatgjata Materiale	Toke & Truall	Ndertesa	Makineri dhe pajisje pune	Mjete Transporti	Pajisje elektronike	Mobileri dhe pajisje zyre	Totali
Gjendje 01.01.2016	24,886,889	8,333,216	96,893,428	6,596,470	784,180	1,288,703	138,782,886
Shtesa	141,033,563	13,961,650	2,821,273	115,200		108,000	158,039,686
Pakesime							0
Saktesim grupi							0
Gjendje 31.12.2016	165,920,452	22,294,866	99,714,701	6,711,670	784,180	1,396,703	296,822,572
Amortizimi							
Gjendje 01.01.2016	0	-983,655	-50,347,066	-2,447,386	-315,011	-164,991	-54,258,109
Shtesa	0	-367,478	-384,2053	-831,737	-117,292	-239,142	-5,397,702
Pakesime							0
Gjendje 31.12.2016		-1,351,133	-54,189,119	-3,279,123	-432,303	-404,133	-59,655,811
Vlera neto 01.01.2016	24,886,889	7,349,561	46,546,362	4,149,084	469,169	1,123,712	84,524,777
Vlera neto 31.12.2016	165,920,452	20,943,733	45,525,582	3,432,547	351,877	992,570	237,166,761

Keto aktive jane prone e shoqerise, jane dokumentuar ne menyre te rregullt dhe perdoren ne funksion te aktivitetit te shoqerise. Shtesa e aktiveve ne ndertesa nuk eshte vene ne perdorim gjate vitit 2016, ndaj nuk eshte llogaritur amortizim per vitin 2016. Po keshtu linja e prodhimit per 7.4 muaj ka qene e klasifikuar si AAM per shitje dhe nuk eshte llogaritur amortizim per kete periudhe. Me pas manaxhimi i shoqerise ka marre vendim per ta futur perseri linjen si AAM per prodhim te produkteve.

6. Detyrime ndaj institucioneve te kredise

	31.12.2016	31.12.2015
Huamarrje bankare ne BKT	0	1,875,078
Huamarrje bankare ne Intesa San Paolo (pjesa ASH)	11,387,874	0
TOTAL	11,387,874	1,875,078

Ne kete rubrike ishte paraqitur pjesa afatshkurter e huase se marre ne vleren 10.000.000 leke per nje afat 3-vjecar ne BKT dega Vore, ne baze te kontrates dt.11/06/2013, hua e cila eshte mbyllur gjate vitit 2016

Ne kete rubrike eshte paraqitur pjesa afatshkurter e huase afatgjate te marre ne Intesa San Paolo Bank me vlere 1.000.000 EUR, per nje afat 10-vjecar, nga 19 Korrik 2016 deri 19 Korrik 2016. Norma e interesit e aplikuar mbi kredine eshte 4% mbi shumen e papaguar te huase.

7. Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit

Emertimi	31.12.2016	31.12.2015
Furnitore per mallra dhe sherbime	13,235,865	8,680,301
Kreditore te tjere (afatshkurter)	103,977,000	25,000,000
TOTAL	117,212,865	33,680,301

Ne rubriken "Furnitore per mallra dhe sherbime" jane paraqitur detyrimet ndaj te treteve per blerje sherbimesh apo mallrash, te blera deri me date 2016, por qe do te paguhen pas dates 31.12.2016.

Ne rubriken "Kreditore te tjere" jane paraqitur detyrimet per huate e marra nga individe te ndryshem si dhe nga ortakët.

8. Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve

	31.12.2016	31.12.2015
Paga	6,400,951	6,256,573
Sigurime Shoqërore dhe te Ngjashme	759,775	710,537
TOTAL	7,160,726	6,967,110

9. Të pagueshme për detyrimet tatimore

	31.12.2016	31.12.2015
Shteti - Tatim mbi paga	41,942	40,508
Shteti - tatim ne burim	6,900	0
Shteti - tatim fitimi	0	4,208,622
TOTAL	48,842	4,249,130

Per llogaritjen e detyrimeve tatimore shoqeria ka respektuar kerkesat e Ligjit "Per TVSH-ne", per "Tatimin mbi te ardhurat" etj, te zbatueshme per aktivitetin e shoqerise tone. Detyrimet tatimore te papaguara me date 31.12.2016 sipas natyres se tyre dhe vlerat perkatese jane si me lart.

Te gjitha keto detyrime tatimore jane paguar ne Janar 2017.

10. Detyrime ndaj institucioneve te kredise

	31.12.2016	31.12.2015
Huamarrje afatgjate bankare ISP Bank	119,245,477	0
TOTAL	119,245,477	0

Ne keto rubrike eshte paraqitur pjesa afatgjate e huase afatgjate te marre ne Intesa San Paolo Bank me vlere 1.000.000 EUR, per nje afat 10-vjecar, nga 19 Korrik 2016 deri 19 Korrik 2016. Norma e interesit e aplikuar mbi kredine eshte 4% mbi shumen e papaguar te huase. Ky shenim te lexohet sebashku me shenimin nr.6 me sipër.

11. Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit

	31.12.2016	31.12.2015
Hu ate marra	60,823,000	43,500,000
TOTAL	60,823,000	43,500,000

Ne keto rubrike eshte paraqitur detyrimi per hua ndaj individeve dhe ortakëve, me afat shlyerje pas dates 31.12.2017. Huate jane marre pa interes (me perjashtim te nja kontrate).

12. Kapitalli

Emertimi		31.12.2016	31.12.2015
Kapitali i paguar			
Ndricim Osmani	16.00%	13,761,659	13,761,659
Ismail Osmani	0 %	0	14,621,763
Zoje Osmani	5.67%	4,873,921	0
Edvin Osmani	5.67%	4,873,921	0
Ermal Osmani	5.67%	4,873,921	0
Sulejman Osmani	17.00%	14,621,763	14,621,763
Fatbardh Osmani	17.00%	14,621,763	14,621,763
Ilmi Osmani	16.00%	13,761,659	13,761,659
Altin Osmani	17.00%	14,621,763	14,621,763
TOTAL	100.00%	86,010,371	86,010,371

Sikurse shihet nga tabela, vlera e kapitali te regjistruar nuk ka ndryshuar krahasuar me vitin 2015, por ka ndryshuar perberja e ortakise, si rezultat i regjistrimit te efekteve te akt trashegimise nr.2323 date 12.06.2016 i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Durres.

13. Rezerva

Emertimi	31.12.2016	31.12.2015
Rezerva ligjore	29,158	29,158
Rezerva per investime	36,913,221	0
TOTAL	36,942,379	29,158

Po keshu referuar vendimit te asamblese date 28.06.2016, eshte bere miratimi i pasqyrave financiare te vitit 2015 dhe fitimi i vitit 2015 me vlore 42,913,221 leke eshte caktuar per te krijuar rezerva per investime me vlore 36,913,221 leke dhe 6,000,000 leke eshte caktuar per tju shperndare ortakëve.

14. Rezultati i ushtrimit

Emertimi	31.12.2016	31.12.2015
Total te ardhura	373,345,303	395,712,238
Total shpenzime (perfshire tatim fitimi)	-362,455,661	-353,114,185
TOTAL	10,889,642	42,598,053

Sikurse shihet rezultati financiar i vitit 2016 eshte ulur ndjeshem krahasuar me vitin 2015, ulje e cila ka ardhur si rezultat i rënies se te ardhurave me 5.65% (kryesisht e eksporteve) dhe i rritjes se shpenzimeve me 2.64%.

15. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

	31.12.2016	31.12.2015
Shitje e produkteve te gatshem brenda vendit	204,626,641	186,766,571
Shitja e produkteve te gatshme per eksport	85,420,332	108,536,304
Te ardhura nga komisionet e sherbimit per naften	0	713,387
Te ardhura nga shitja e naftes	78,067,651	85,725,765
TOTAL	368,114,624	381,742,027

Ne kete rubrike jane paraqitur te ardhurat neto nga aktiviteti kryesor i shoqerise qe eshte shitja me shumice dhe pakice te produkteve ushqimore, shitje karburant me pakice, te cilat ne menyre te permbledhur jane paraqitur ne tebele.

16. Ndryshimi ne inventarin e produktit te gatshem

Emertimi	31.12.2016	31.12.2015
Ndysht.gjendje produkti	-3,133,622	13,728,983
TOTAL	-3,133,622	13,728,983

17. Lende e pare dhe materiale te konsumueshme

Emertimi	31.12.2016	31.12.2015
Kosto e produkteve te shitura	-220,765,888	-202,910,007
Kosto e karburantit te shitur	-68,174,318	-77,101,087
Bl.energji,avull,uje	-10,640,884	-10,869,157
TOTAL	-299,581,090	-290,880,251

Ne menyre analitike, daljet e materialeve per prodhim dhe te mallrave per shitje si dhe te tjera te nevojshme per funksionimin normal te shoqerise, jane paraqitur ne kete tebele.

18. Shpenzime te personelit

Emertimi	31.12.2016	31.12.2015
Pagat dhe shperblimet e personelit	-31,911,383	-25,035,414
Sigurimet shoqerore dhe shendetesore	-5,338,833	-4,191,260
TOTAL	-37,250,216	-29,226,674

19. Shpenzime te tjera shfrytezimi

Emertimi	31.12.2016	31.12.2015
Takse doganore per blerje malli	-801,244	-1,396,217
Qira	-500,500	0
Mirembajtje dhe riparime	-1,797,470	-1,641,333
Sigurime	-28,512	-23,720
Te tjera	-2,133,104	-1,271,167
Sherbim doganor	-31,000	0
Shkarkim i inventarit te imet	-123,174	0
Paga ndermjetes, honorare	-506,667	-260,000
Publicitet, reklama	-417,430	-100,856
Transferime, udhetime dieta	-292,576	0
Shpz.postare e telekom.	-1,396,358	-1,847,563
Transporte per blerje	-2,698,728	-2,650,786
Transporte per blerje Boxline	-79,058	0
Sherbime bankare	-507,371	-826,629
Taksa dhe tarifa vendore	-769,344	-417,900
Gjoha dhe demshperblime	-2,555,263	-1,820,932
Zbritje akorduar klienteve	-135,230	0
TOTAL	-14,773,029	-12,257,103

Shpenzimet e tjera te veprimtarise, te klasifikuara sipas natyres, jane paraqitur ne kete tabelë.

20. Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme

	31.12.2016	31.12.2015
Te ardhura nga veprimet valutore	2,097,057	612,014
TOTAL	2,097,057	612,014

21. Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme

	31.12.2016	31.12.2015
Humbje nga veprimet valutore	-242,764	-1,072,109
Shpenzime per interesa	-2,814,365	-390,326
TOTAL	-3,057,129	-1,462,435

22. Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin

	31.12.2016	31.12.2015
Fitimi para tatimit	13,286,136	50,807,483
Shpenzime te pazbritshme	2,690,493	1,820,932
Gjoha dhe demshperblime	2,555,263	1,820,932
Zbritje akorduar klienteve	135,230	0
Fitimi tatimor i ushtrimit/ Humbje	15,976,630	52,628,415
Humbje te mbartura	0	0
Fitimi i tatueshem i ushtrimit	15,976,630	52,628,415
Tatim fitimi 15%	-2,396,494	-7,894,262
Fitimi neto	10,889,642	42,913,221

Fitimi para tatimit është 13,286,136 leke .Shpenzimet e parajohura te periudhes jane 2,690,493 leke, te cilat kane rritur fitimin e tatueshem te periudhes, i cili arrin ne vleren 15,976,630 leke. Tatim fitimi per vitin 2016 i llogaritur mbi keke baze eshte 2,396,494, Leke, nga 7,838,644 Leke qe ishte ne vitin 2015.

Vlera totale e paradhanieve te paguara per tatim fitimin gjate vitit 2016 ishte 6,586,284 Leke, nga e cila pasi zbritet vlera e tatim fitimit 2016 per shumen 2,396,494 leke, rezulton qe shoqeria ka mbipaguar tatim fitimi ne shumen 4,189,790 leke (shenimi 3).

23.Transaksione me palet e lidhura

Gjate vitit ushtrimor 2016 shoqeria ka kryer transaksione me palet e lidhura (ortaket e shoqerise dhe administratorin) per financime afatshkurter, dhe paga, qira dhe shperndarje te fitimit.

24.Ngjarjet pas dates se bilancit

Deri ne date 20.03.2017, date ne te cilen ka perfunduar mbyllja e pasqyrave financiare te vitit 2016, nuk ka patur ngjarje materiale, te cilat te jepnin efektin e tyre ne gjendjen dhe rezultatin e raportuar per periudhat ushtrimore te meparshme.

Pasqyrat financiare jane autorizuar nga administrator i shoqerise me date 20 Mars 2017.

Pergatiti

Ermal Osmani



Administrator

Ndricim Osmani

